

GJL. nr. 987/2012

AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DPK/DMP

02

Nr. Prot. 03-3797/12
Prot. No. 03-3797/12
Data 23.10.2012
Date 23.10.2012



GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Dafina Myrtaj, nga Prishtina nëpër mes avokatit Bardh Ademaj, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18207/2012 të dt. 30.07.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 dhe konform nenit 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më dt. 21.09.2012, merr këtë:


AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e **BAZUAR**.
NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 18207/2012 të dt. 30.07.2012, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar; ashtu që të pandehurës Dafina Myrtaj nga Prishtina, për veprën kundërvajtëse të sanksionuar sipas neni 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 para. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, i shqiptohet gjoja në shumë prej 700 (shtatëqind) Euro, konform të nenit 9 të LK. të cilën gjobë është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në të kundërtën gjoja e shqiptuar do t'i zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 15 Euro, për një ditë burgimi
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

ARSYETIM

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr. regj. 18207/2012 të dt. 30.07.2012, të pandehurën Dafina Myrtaj, nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse si Zyrtare e Lartë Publike, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjensionin Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publike dhe për këtë është gjobitur me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro.
Me të njëjtën aktvendim e pandehura është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi e pandehura Dafina Myrtaj ka paraqitur ankesë nëpër mes avokatit Bardh Ademaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit dhe vendimit mbi gjobën e shqiptuar, me arsyetim se: nuk e kam bërë deklarin e pasurisë për shkak të gjendjes tejte të rëndë shëndetësore kam qenë e penguar që ta kryej obligimin ligjor pasi që një kohë të gjatë për shkaqe të gjendjes së rëndë shëndetësore-psikike dhe komplikimeve tjera nuk kam pasur qasje në punë por as në komunikim elektronik zyrtar, si dëshmi ofron prova-raportet mjekësore dhe shenjat për pushim mjekësor, duke shtuar se prej datës 23.02.2012 deri më 22.03.2012 kam qenë në pushim mjekësor dhe në momentin që jam kthyer në vendin e punës për shkak të gjendjes shëndetësore kam qenë tërësisht jashtë rrjedhave. Nuk qëndrojnë thëniet se e kam neglizhuar rastin, andaj konsideroj gjoja e shqiptuar është e gabuar dhe e rëndon gjendjen. Tani shpallim pasi që të ardhurat personale mujore tani kam 360 Euro, për shkak se tani nuk e ushtroi postin e



2.

ushtruesit të detyrës së drejtorit për çka ofron si provë vërtetimin nr. 605/12, të datës 17.08.2012, sipas të cilit postin e ka ushtruar deri më datën 30.03.2012. Njëherit shtori se jam e moshës së re, kurrë më parë nuk kam ardhur në kundërshtim me ligjin propozon që Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, ta ndryshoi aktvendimin ashtu që e njëjta të lirohet nga përgjegjësia dhe gjoba e shqiptuar, ose aktvendimi të priset dhe lënda të kthehet në riprocedurë.

Kolegji i kësaj gjykate duke e vlerësuar ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimin e goditur, deklarin e të pandehurës Dafina Myrtaj, në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 10.07.2012, e cila në mbrojtjen e vet e pranoi se nuk e ka bërë deklarin e pasurisë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe si dëshmi ofroi prova (Vendimin për pushim mjekësorë) sipas të cilit nga data 23.02.2012, deri më datën 22.03.2012, ka qenë në pushim mjekësor për shkak të problemeve shëndetësore gjatë shtatzënisë, e pranon se emaili nga AKK kishte qenë në kompjuterin e saj, por për shkak të gjendjes shëndetësore atë nuk e ka vërejtur, kurse gojarisht nuk e ka informuar askush se duhet ta deklaroi pasurinë; dëshmisë së dëshmitarit-Zyrtar i AKK-së Enis Sadiku, në procesverbal të datës 24.02.2012, i cili dëshmon se e pandehura ka qenë e informuar nëpërmes pikës kontaktuese, por të njëjtës nuk i është bërë ndonjë kërkesë e veçantë personalisht, si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike se e pandehura ka kryer vepër të përshkruar në dispozitivin e aktvendimit të goditur për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse.

Megjithatë Kolegji e ndryshoi aktvendimin e goditur vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar në vështirim të nenit 9 të Ligjit mbi kundërvajtje, duke e zbutur gjobën e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë duke marrë parasysh se pasojat e veprës kundërvajtëse nuk ishin të rënda, se ekzistojnë rrethanat lehtësuese të cilat vejnë në dukje se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit. Andaj Kolegji i mori parasysh përveç tjerash, rrethanat lehtësuese se e pandehura është e moshës së re, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, se ka të ardhura mujore në lartësi prej 360 Euro, se nga data 30.03.2012, nuk e ushtron më postin e zyrtarit të lartë, se tani është në pushim të lehonisë, se e pranoj se për shkaqe shëndetësore nuk ka arritur që ta deklaroi pasurinë dhe lidhur me këtë ofroj edhe prova, se gjoba e shqiptuar nga gjykata shkallës së parë do të vështirësonte gjendjen ekonomike sociale të saj (si nënë e re). Andaj Kolegji duke u bazuar në rrethanat e cekura më lartë e ndryshoi aktvendimin e goditur sa i përket lartësisë së gjobës të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro, ashtu që të pandehurës ia shqiptoi gjobën në shumë prej 700 (shtatëqind) Euro, konform nenit 9 të LK-së duke pasur për bazë të gjitha faktet dhe rrethanat në vështirim të nenit 7 të Ligjit mbi kundërvajtje, duke llogaritur se edhe me këtë gjobë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit që e pandehura në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të tilla apo të ngjashme. Më sa u tha më lartë konform të nenit 221 të LMK-u vendos si në dispozitiv. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

2012-07-27 14:00:00